



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr. 51, dt. 23.12.2024

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligji Nr.9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2025", të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, Vendimit të Këshillit të Qarkut "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2025-2027 për Këshillin e Qarkut", VKM nr. 673 dt. 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025 si më poshtë:

<i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>250.8 milion lekë</i>
Nga kjo	- Transfera e pakushtëzuar	82.8 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	36.9 milion lekë
	- Te ardhura nga rimbursimi i Programeve të BE	54.5 milion leke
	- Të ardhura të trashëguara nga viti 2024	76.6 milion lekë
	- Transfera e kushtëzuar	
<i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>250.8 milion lekë</i>
Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	41.1 milion lekë
	- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.5 milion lekë
	- Për investime në Këshillin e Qarkut	135.6 milion lekë
	- Kontribut bashkëfinancim në Proj. BE	40 milion lekë
	- Projekti STEP	0.2 milion leke
	- Për fond rezerve	2 milion lekë


Mbeshtetja per zhvillim ekonomik

-Projekti: "Organizimi dhe Mbështetje të Rinjve në Tarizëm: 20 Guida Turistike për Rajonin"	3.5 milion lekë
- Konferenca shkencore për prioritetet e zhvillimit te Qarkut	1.5 milion lekë

shpenzuese, miratohen nga nepunesi autorizues i njesise se qeverisjes vendore, nga e cila varet njësia shpenzuese.

7. Projektet e investimeve në bashkepunim me bashkitë(raporti 60% me 40%) dhe Projektet e studimit ne bashkepunim me bashkitë (raport 70% me 30%), do të fillojnë të zbatohen vetëm pasi Bashkia përkatëse të ketë derdhur pjesën e saj takuese të fondit si kontribut për Këshillin e Qarkut.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit në Këshillin e Qarkut, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit Korçë.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2025.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



Miratuar me / 19 / Vota
Vota Pro / 19 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /23/12/2024

Konceptoi O.Beqiraj

Juristi M.Bylykbashi

Sek.K.Qarkut B. Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimet njerëzore
dhe zhvillimit të teritorit

RELACION

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, administrata e Këshillit të Qarkut ka punuar për hartimin e shifrave të buxhetit për vitin 2025.

Për hartimin e buxhetit jemi mbështetur në:

- Programi buxhetor afatmesëm 2025-2027 të miratuar nga Këshilli i Qarkut.
- Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2024 për periudhën 3/mujore.
- Analiza financiare e realizimit të pritshëm të treguesve ekonomike për vitin 2024.
- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Programi i aktiviteteve për vitin 2025 për institucionin e Këshillit të Qarkut të lidhura këto me objektivat e zhvillimit të qeverisjes qendrore.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore dhe nënligjore.

Së pari ju paraqesim nje analizë të shkurtër të realizimit të buxhetit për vitin 2024. Zbatimi i buxhetit për vitin 2024 ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat i një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vetë institucionit.

- **Realizimi i shpenzimeve**

Realizimi i pritshëm i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2024 pritet të jetë 65 milion lekë, nga 144.5 milion leke të planifikuara ose 45 % , përjashtuar DAMT-në në Qark. Më poshtë po analizojmë realizimin e shpenzimeve të planifikuara vetëm për vitin 2024.

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

BUXHETI I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2025

ne 000/ leke

TË ARDHURA			SHPENZIME		
Nr.	Burimet e Financimit	Plani 2025	Nr.	Funksionet	Plani 2025
1	Transfertat	82809	1	Funksionet e veta	
	Transferta e pakushtëzuar	82809	a.	Administrata e Këshillit të Qarkut	41061.5
	Transferta e kushtëzuar			Paga Administrata	27035.7
				Sigurime shoqërore e shëndetsore	4345.8
2	Të ardhurat	168029.9		Shpen. Operative	6680
	Kcnt.financiar bashki viti 2025	36481.2	b.	Shpërbllim per Kryesine e K.Qarkut	1560
	Të ardhurat e veta	430		Për antarët e Kryesisë Këshillit Qarkut	1560
	Të ardhura të trashëguara 2024	76618.7	c.	Investimet	135648
	Të ardhura nga rimbursimet nga projektet e mbyllura	54500		Administrata e Këshillit të Qarkut(01110)	2200
				Shërbimet vendore	15423
				Arsimi baze	22
				Mbështetja per zhvillim ekonomik (04130)	118503
				Rrjeti rrugor rural (04520)	0
				Trashëgimia kulturore (08220)	1500
			2	Programe të tjera,shpenzime operative	
				Mbështetja per zhvillim ekonomik	6800
				Projekti: "Organizimi dhe Mbështetje të Rinjve në Turizëm - 20 Guida Turistike për Rajonin"	3500
				Konferenca shkencore per prioritetet e zhvillimit te qerkut: Turizmi, Bujqesia, Burimet njerezore dhe mundesite e aplikimit te teknologjive smart nje qasje per pergatijen e Strategjise sektoriale te zhvillimit per Rajonin Korce.	1500
				Prezantimi i Produktit Turistik në Panaire Nderkombetare	2600
				Aktiviteti "Sportistet me te mire te Qarkut"	1000
				Projekti: "Studentet ne siper marrje e lire" "Student in Free Enterprise"	1500
				Perkujdesi social	10060
				Projekte sociale me Bashkite e qarkut "Moshë e trete" dhe "Femijet e Komuniteteve"	9800
				Te verberit	410
				Aktiviteti Tetori Roze	500
				Qendra rezidenciale	150
				Trashëgimia kulturore	10550
				Aktivitete kulturore lokale	1500
				Projekti: "Olimpiadat e Shkencave për Shkollat e Mesme të Qarkut Korçë"	700
				Festivali Folklorik "Autonom Fest"	1800
				Prçketi ARTKID	730
				Prçketi: "Nxitja e Sipërmarrjes në Artizanat dhe Produktet tradicionale në Shkollat e Mesme Profesionale"	1000
				Konferenca "Filantropia ne Rajonin e Korces"	400
				Konferenca Zai Fundo(Llazar Fundo)nje personalitet europian	300
				Proekti: "Rinart Qarku Korce"	1500
				Ekspozita e Koleksionistëve "Krahina Autonome e Korçës"	120
				Pro.ekti Etnokid	1000
				Promovimi i produkteve bujqesore dhe fermereve te Rajonit	1000
				Konkursi "Gjuha ime"	500
			3	Per pjesemarrje ne Projektet e reja te BE-se	40000
			4	Projekti STEP	1594
			3	Fond rezervë	20000
			4	Funksionet e deleguara	
			a.	Crejtoria e Administrimit Mbrojtjes Tokes	0
				Paga	
				Sigurime shoqërore e shëndetsore	
				Shpen. operative,	
	TOTALI TË ARDHURA	250838.9		TOTALI SHPENZIME	250838.9

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Erjon NEXHIPI

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Sektori I Financës, Zhvillimit Ekonomik e Shërbimeve

TABELA E LLOGARITJES TË TË ARDHJRAVE TË KËSHILLIT TË QARKUT

VITI 2025

	Emertimi i taksave e tarifave	Njesi	Cmimi	Nr. Njesi	Te archura
	Arkivi I Urbanistikes				
I	Ligji Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes vendore" I ndryshuar				
1	vertetim per vendimarje ne KRRT etj.	leke	100	0	0
2	Vertetim per dokumenta nga arkivi I urbanistikes	leke	500	0	0
3	Marje fotokopje projektesh nga arkivi I urbanistikes format A4	leke	200	2	400
4	Marje fotokopje projektesh nga arkivi I urbanistikes format A3	leke	400	8	3200
5	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik I urbanistikes format A4	leke	1000	2	2000
6	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik I urbanistikes format A3	leke	1500	2	3000
	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne qark				
II	Urdher nr. 183 dt. 26.05.2011 "Per tarifat e sherbimeve qe kryhen nga Drej.				
	Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne qark				
1	Vertetim pronesia para vitit 1946	leke	1000	137	137000
2	Vertetim pronesia pas vitit 1946	leke	1000	137	137000
3	Vertetim negativ para reformes per ne gjykate	leke	500	10	5000
4	Vertetim pronesia per Agjensine e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave	leke	500	30	15000
5	Vertetim pronesia qe kerkohet per statusin te pastrehe	leke	200	10	2000
6	Konfirmim I vertetimeve per ndihme ekonomike e perkrahje sociale te	leke	100	54	5400
7	Harta e skica planimetrike kadastrale	leke	1000	50	50000
8	Vertetime per kategoriazimin e tokes, sipas bonitetit	leke	1000	50	50000
9	Vertetim me te dhena nga formulari nr. 6	leke	500	40	20000
III	Udhezimi I Ministrit te Financave per zbatimin e buxhetit dhe Vendimi I K.Qarkut				
1	Kontributi financiar Bashkive per vitin 2025				36481184
3	Te ardhura te trasheguara nga 2024				76618748.5
5	Te ardhura nga rimbursimet per projektet e perfunduara te BE-se				54500000
IV	Transfertat				
1	Transferta e pakushtezuar				82808966
2	Transferta e kushtezuar				
	Totali I te ardhurave				250838898.5

Erjon NEXHIPI

Kryetar I Këshillit të Qarkut

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Sektori I Financës, Zhvillimit Ekonomik e Shërbimeve

TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT TË QARKUT
PER VITIN 2025

Nr.	Emertimi I taksave e tarifave	Njesi	Tarifa
I	Sektori i Urbanistikës		
1	Vertetim per verdimarje ne KRRT etj.	leke	1000
2	Vertetim per dokumenta nga arkivi I urbanistikës	leke	500
3	Marje fotokopje projektesh nga arkivi I urbanistikës format A4	leke	200
4	Marje fotokopje projektesh nga arkivi I urbanistikës format A3	leke	400
5	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik I urbanistikës format A4	leke	1000
6	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik I urbanistikës format A3	leke	1500
II	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne qark		
1	Vertetim pronesie para vitit 1946	leke	1000
2	Vertetim pronesie pas vitit 1946	leke	1000
3	Vertetim negativ para reformes, per ne gjykatë	leke	500
4	Vertetim pronesie per Agjensine e kthimit dhe kompesimit te pronave	leke	500
5	Vertetim pronesie qe kerkohet per Statusin te pastrehe	leke	200
6	Konfirmim I vertetimeve per ndihme ekonomike e perkrahje sociale te ardhura nga komuna dhe/ose Bashkia	leke	100
7	Harta e skica planimetrike kadastrale	leke	1000
8	Vertetim per kategorizimin e tokes sipas bonitetit	leke	1000
9	Vertetim me te dhena nga formulari nr.6	leke	500

Erjon NEXHIPI

Kryetar I Këshillit të Qarkut



KESHILLI I QARKUT

Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve e Burimeve Njerëzore

REALIZIMI I PRITËHMË I BUXHETIT PËR VITIN 2024 DHE PLANI I BUXHETIT 2025

ne lekë

Nr.	Emertimi	Buxheti 2024 i ndryshuar	Plan vjetor 2024	I pritshmi 2024	P/F % 2024	Plani		Ne %		Financim Grantë	Financim Ardhurat	Financim Rimbursimet per projektet e huaja	Financim Trashegimi
						2025	Pl.25/P.24	Ne %	Pl.25/F.24				
I	Ajfinn. K Qarkut												
	- paga administrata	19056000	19056000	16891389	88.46	27026709	141.59	160.06		26413222.5			622486.5
	- sigurime administrata	3187500	3187500	2588291	80.57	4345778	136.34	108.21		4345778			0
	- shpen operative	7960624	7960624	5480171.39	68.84	9679696	121.60	176.84		9679696			0
	- shperb. antarët Kryesise Kesh. Qarkut	1224000	1224000	1224000	100.00	1560000	127.45	127.45		1560000			0
	- Investime	78449737.36	60349737.36	21928915.24	36.33	119,724,960.00	198.39	546.02	15,500,000.00	36481184	14500000		53243776
	Studime dhe luanje projektuale(70% nje %0%)	17075950.94	17075950.94	0	0	15020000.00	88.26			0	0		16020000
	- Pjesemarie ne Projektet e B. Europlan					45500000					45500000		0
	- Proj STEP	159486	159486	0	-	159486	100.00						159486
	- Shpenzat e te Verberve	410000	410000	0	-	410000	100.00			410000			0
	Projekte sociale me bashkille e Qarkut "Moshë e trete dhe "Famijet e komuniteteve"	5657190	5657190	3218959.54	56.92	9000000	159.09	279.51	9000000				0
	- Qendra Rezidenciale Zhvillimit Korce	150000	150000	150000	100.00	150000	100.00	100.00	150000				0
	- Aktiviteti Tefor Ruce	500000	500000	418440	83.29	500000	100.00	120.07	500000				0
	Mbeshtetje per transportin rrethqytetas per te rinjte	3600000	3600000	0	-	0	-						0
	- Mbeshtetje per ICT's	800000	800000	285000	35.63	0	-	-					0
	- Mbeshtetje per te rinjte ne bujqesi, 20 bletertes te rinj	2907396	2907396	2907396	100.00	0	-	-					0
	Kontribut Bahkia Korce per Qendren aritake	3000000	3000000	3000000	100.00	0	-	-					0
	Projekti "Organizimi dhe mbeshtetje e te rinjve ne turizem, 20 guda turistike per Rajonin	2200000	2200000	0	-	3500000	159.09		1300000				2200000
													0
	Konferenca per prioritetet e zhvillimit te Qarkut, nje qasje per pergatjen e strategjise sektoriale	800000	800000	0	-	1500000	187.50		700000				800000
	Prezantimi i produktit turistik rajonal ne panairë nderkombetare	2500000	2500000	2500000	100.00	2800000	112.00	112.00	2500000				300000
	Aktiviteti sportistet me te mire te qarkut	1000000	1000000	0	-	1000000	100.00						1000000
	Projekti "Studentet ne sipermarje te lire	800000	800000	0	-	1000000	125.00		200000				800000
	Shkolla e liderhipit	3000000	3000000	0	-	0	-						0
	Shpenzime per aktivite kulturore lokale	840671	840671	835000	99.33	1500000	178.43	179.64	1500000				0
	Olimpijadi e shkencave per shkollet e mesme te Qarkut Korce	505600	505600	505600	100.00	700000	138.45	138.45	700000				0
	Festivali Folklorik "Autonom fest"	1170000	1170000	1170000	100.00	1800000	153.85	153.85	1800000				0
	Projekti: "Nucia e sipermarjes ne artizanat dhe produktet tradicionale ne shkollet e mesme profesionale	403521	403521	403521	100.00	1000000	247.82	247.82	1000000				0
	Konferenca shkenore "Korca nga lufta e pare boterore ne veteqeverim	300000	300000	300000	100.00		-	-					0
	Konferenca shkenore "80 vjetori i clirimt, shqiptaret dhe koalicioni antifashist	300000	300000	300000	100.00		-	-					0
	Konferenca Filantropia ne rajonin e korces					400000			400000				0
	Konferenca Zai Fundo(Lazar Fundo) nje personalitet europian					300000			300000				0
	Rinehow Qarku Korce	529999	529999	529999	100.00								0
	Rin-Art Qarku Korce					1500000			1500000				0
	Projekti "A Ulgu"					730000			730000				0
	Konkursi "Gjuha Ime"					500000			500000				0
	Projekti EthoKid					1000000			1000000				0
	Promovimi i produkteve bujqesore dhe formereve te rajonit te korces					1000000			1000000				0
	Ekipozita "Krahina autonome e Korces	120000	120000	120000	100.00	120000	100.00	100.00	120000				0
	- fond rezerve	4388646	3958646	0	-	2000000	50.52			430000			1570000
	Shuma	163034827.3	144294827.3	64733678.17	44.80	250,836,996.00			82,906,966.80	36,911,184.00	54,500,000.00		76,618,748.80
II	DAMT ne Qark												
	- paga administrata	8250000	8250000	595350	72.19		-						0
	- sigurime administrata	1423000	1423000	994540	69.89		-						0
	- Shpenzime operative	300000	300000	198854	66.28		-						0
	- Shperblim fondi i vecante					0							0
	Shuma	9973000	9973000	7148744	71.68	0	-	-	0	0	0	0	0
	TOTAL QARKU	173007927.3	164477927.3	71882422.17	46.53	250838899			82808966.8	36911184	54500000		76618748.8

Oljona Beqiraj
Pergjegjese e Financës



Realizimi i pritshëm i shpenzimeve për vitin 2024

Nr.	Emertimi	Buxheti	Plan vjetor	I pritshmi	P/F %
	Shpenzimeve	2024 I ndryshuar	2024	2024	2024
I	Admin. K.Qarkut				
	- paga administrata	19095000	19095000	15891385	83.46
	- sigurime administrata	3187500	3187500	2558291	80.57
	- shpen.operative	7960524	7960524	5480171.39	68.84
	- shperb.antaret Kryesise Kesh Qarkut	1224000	1224000	1224000	100.00
	- investime	78449737.36	60349737.36	21926915.24	36.33
	-Studime dhe hartim projektesh(70% me 30%)	17075656.94	17075656.94	0	-
	- Pjesemarije ne Projektet e B. European				
	- Proj.STEP	159486	159486	0	-
	- Shoqatat e te Verberve	410000	410000	0	-
	Projekte sociale me bashkite e Qarkut "Moshë e trete dhe "Femijet e komuniteteve"	5657190	5657190	3219959.54	56.92
	- Qendra Rezidenciale Zhvillimit Korce	150000	150000	150000	100.00
	- Aktiviteti Tetori Roze	500000	500000	416440	83.29
	Mbeshtetje per transportin rrethqytetas per te rinjte	3600000	3600000	0	-
	- Mbeshtetje per ICTs	800000	800000	285000	35.63
	- Mbeshtetje per te rinjte ne bujqesi, 20 bleterites te rinj	2907396	2907396	2907396	100.00
	Kontribut Bahkia Korce per Qendren artistike	3000000	3000000	3000000	100.00
	Projekti "Organizimi dhe mbeshtetje e te rinjve ne turizem, 20 guida turistike per Rajonin	2200000	2200000	0	-
	Konference per prioritetet e zhvillimit te Qarkut, nje qasje per pergatitjen e strategjise sektoriale	800000	800000	0	-
	Prezantimi i produktit turistik rajonal ne panaire nderkombetare	2500000	2500000	2500000	100.00
	Aktiviteti sportistet me te mire te qarkut	1000000	1000000	0	-
	Projekti "Studentet ne sipermarje te lire	800000	800000	0	-
	Shkolla e lidershipit	3000000	3000000	0	-
	Shpenzime per aktivite kulturore lokale	840671	840671	835000	99.33
	Olimpiadat e shkencave per shkollat e mesme te Qarkut Korce	505600	505600	505600	100.00

	Festivali Folklorik "Autonom fes:"	1170000	1170000	1170000	100.00
	Projekti: "Nxitja e sipermarjes ne artizanat dhe produktet tradicionale ne shkollat e mesme profesionale	403521	403521	403521	100.00
	Konferenca shkencore "Korca nga lufta e pare boterore ne veteqeverim	300000	300000	300000	100.00
	Konferenca shkencore "80 vjetori I clirimit, shqiptaret dhe koalicioni antifashist	300000	300000	300000	100.00
	Rinshoë Qarku Korce	529999	529999	529999	100.00
	Ekspozita "Krahina autonome e Korces	120000	120000	120000	100.00
	- fond rezerve	4388646	3958646	0	-
	Shuma	163034927.3	144504927.3	64733678.17	44.80
II	DAMT ne Qark				
	- paga administrata	8250000	8250000	5955350	72.19
	- sigurime administrata	1423000	1423000	994540	69.89
	- Shpenzime operative	300000	300000	198854	66.28
	- Shperblim fondi I vecante				
	Shuma	9973000	9973000	7148744	71.68
	TOTAL QARKU	173007927.3	154477927.3	71882422.17	46.53

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore ze rreth 15.4% të totalit të planit vjetor të vitit 2024 ose në vlerë rreth 22.3 milion lekë. Numri i planifikuar i punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2024 ishte 10 punonjës + tre titullarët e zgjedhur, kjo sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2024. Për një pjesë të vitit 2024 kemi pasur edhe një pozicion vakant. Kjo shpjegon edhe realizimin e fondit të pagave me 88.46%. Gjithashtu në mosrealizimin e zërit të pagave ka ndikuar edhe mospërfundimi i fondit të vecantë të parashikuar (5% e fondit të pagave).

Numri i punonjësve të DAMT në qark është 7 punonjës, numër i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, kurse numri faktik është 6 punonjës. Gjatë vitit 2024 nuk kemi pasur lëvizje të punonjësve të kësaj drejtorie. Mbetet vakant pozicioni i drejtorit, gjë që ndikon në mosrealizimin e plotë të fondit të pagave për këtë drejtori.

Mbi bazën e këtyre strukturave ka qënë i miratuar edhe fondi për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Brenda këtij fondi janë financuar të gjitha pagat e administratës së Këshillit të Qarkut. Gjatë vitit ka vazhduar rregullisht pagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, TAP dhe sigurimit suplementar. Gjatë këtij viti nuk u krijua asnjë detyrim i ri në paga e sigurimet shoqërore.

Shpenzimet operative për programin 01110, të financuara për vitin 2024 mendohet të arrijnë në 5.5 milion leke nga 7.9 milion lekë të miratuara dhe kapin 5.5 % të totalit të shpenzimeve. Në këtë zë janë futur shpenzimet për financimin e aktivitetit të institucionit. Disa zëra të shpenzimeve nuk janë realizuar 100%, por është planifikuar që pjesa më e madhe e tyre të mbyllet brenda muajit Dhjetor. Përqindja e tyre e realizimit

(68.8%) është relativisht e ulët për disa arsye. Një pjesë e shpenzimeve nuk u pa e nevojshme të realizohen. Gjithashtu zëra të tjerë të planifikuar si kuotat e anëtarësimit nëpër organizata kombëtare dhe ndërkombëtare apo zëra të tjerë që lidhen me to, nuk u përdorën plotësisht.

Deri në fund të vitit 2024, programi i investimeve është parashikuar të realizohet në shumën 22 milion lekë nga 60.3 milion lekë të planifikuara. Përqindja e parashikuar e realizimit të këtij zëri është 36.3%, një realizim ky shumë i ulët. Pothuajse të gjitha zërat e investimeve të planifikuara në buxhetin e vitit 2024 lidheshin me kontributet e Bashkive, pra ishin në një formë bashkëpunimi. Të gjitha bashkitë I kanë derdhur kontributet e tyre për Këshillin e Qarkut në dy muajt e fundit, cka solli pengesë për prokurimin e tyre në kohë. Kjo bëri që % e realizimit të këtij zëri të jetë në këto nivele kaq të ulta. Gjithsesi të gjitha projektet e investimeve që nuk u realizuan në vitin 2024 janë planifikuar të realizohen brenda vitit 2025.

Në zbatim të rregjistrimit të prokurimeve të fondeve publike, të gjitha shpenzimet e prokuruarat dhe të realizuarat gjatë vitit 2024 janë financuar duke mos krijuar asnjë borxh të ri.

Zëri studime dhe hartim projektesh, për të njëjtën arsye si më sipër është me realizim 0.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 janë finalizuar me sukses pjesa më e madhe e projekteve të planifikuara nga Këshilli I Qarkut sipas miratimit në buxhetin e vitit 2024. Përmendim këtu:

- Projektet sociale me moshën e tretë dhe fëmijët e komuniteteve e cila pritet të ketë një realizim rreth 57%. Janë realizuar pjesa më e madhe e aktiviteteve për qendrat e të moshuarve. Këtu përmendim edhe fondin social nga Ministria e Shëndetësisë I cili u përdor vetëm për paga dhe sigurime për stafin e punësuar në qendrat ditore të të moshuarve. Përqindja e realizimit të kësaj transferte të kushtëzuar pritet të jetë rreth 82% pasi struktura e punonjësve nuk ka qënë e plotësuar që në muajin shkurt, atëherë kur filloi të aplikohet fondi social për Këshillin e Qarkut Korçë.

- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë 150 000 lekë

- Aktiviteti Tetori Rozë 416 440 lekë

- Aktiviteti mbi bletarinë dhe bletërritësit e rinj 2 907 396 lekë

- Kontribut Bashkia Korçë për Qendrën Artistike 3 000 000 lekë

- Prezantimi I Qarkut në Panairin Philoxenia 2 500 000 lekë

- Mokra nifest 300 000 lekë

- Piktorët e vegjël 200 000 lekë

- Mbështetje për Qendrën e Artit dhe Kulturës në Bashkinë Korçë 315 000 lekë

- Olimpiadat e shkencave në shkollat e mesme 505 600 lekë

- Autonom fest 1 170 000 lekë

- Nxitja e sipërmarjes në artizanat në shkollat e mesme profesionale 403 521 lekë

- 2 konferencat shkencore 600 000 lekë

- Rinshoë 529 999 lekë

- Ekpozita e krahinës autonome të Korçës 120 000 lekë

Gjatë vitit 2024 nuk kemi pasur shpenzime për projekte me financim të huaj pasi të gjitha projektet janë mbyllur brenda vitit 2023. Gjatë këtij viti kemi planifikuar vetëm të ardhura nga rimbursimet për fondet e shpenzuara për këto projekte të BE-së, pasi të gjitha

projektet kanë qënë me parafinancim, që do të thotë se shpenzimet njihen vetëm pas certifikimit të tyre dhe disbursimi i fondeve vjen pasi shpenzimet për aktivitetet janë kryer. Këshilli i Qarkut pret akoma fonde për rimbursimet e shpenzimeve të kryera nga buxheti i tij.

- **Realizimi i të ardhurave**

Për vitin 2024 burimet e të ardhurave në buxhetin e Këshillit të Qarkut kanë qënë:

Ne 600/leke

Te ardhurat	Plani 2024	I pritshmi 2024	Realizim ne %	Diferenca ne vlere
Transferta e pakushtëzuar	78087.7	78087.7	100	0
Kontributi financiar I bashkive viti 2024	27307	13307	48.7	14000
Te ardhura nga taksat e tarifat e shërbimeve	430	160	37.2	270
Te ardhurat e trashëguara viti 2023	45793	45793	100	0
Te ardhura nga rimbursimet e projekteve BE	11417	11417	100	0
Transferta e kushtëzuar DAMT	9973	9973	100	0
Transferta e kushtëzuar	8986	8986	100	0
Total 2024	181993.7	167723.7	92	14270

Transferta e pakushtëzuar vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe është përdorur për financimin e funksioneve të veta të miratuara me Vendim të Këshillit të Qarkut në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Vazhdon të mbetet problem realizimi i kontributit financiar të bashkive për llogari të Këshillit të Qarkut. Theksojmë se ky kontribut është burimi kryesor i të ardhurave të vetë institucionit dhe ze një peshë të konsiderueshme në buxhet. Për vitin 2024 vetëm 48.7 e këtij zëri të të ardhurave parashikohet të realizohet me kontributet si më poshtë

Bashkia Korçe 0 lekë
 Bashkia Maliq 2077 mijë lekë
 Bashkia Pogradec 800 mijë lekë
 Bashkia Ersekë 930 mijë lekë
 Bashkia Devoll 8000 mijë lekë
 Bashkia Pustec 1500 mijë lekë

Derdhja e këtyre kontributeve shumë vonë, solli si pasojë edhe mësrealizimin e projekteve të planifikuara për vitin 2024 në bashkëpunim me bashkitë, projektet këto që do të realizohen në vitin 2025.

Derdhja e këtij kontributi financiar të Bashkive për vitin 2025 duhet të shihet me prioritet nga të gjitha këshillat bashkiakë në procesin e miratimit të buxhetit të tyre për vitin 2025. Në varësi të këtij kontributi do të jetë edhe mbështetja financiare e Këshillit të Qarkut për projektet e të gjashta bashkive.

Të ardhurat e tjera nga tarifat e shërbimeve që ofron institucioni si nga kadastra, urbanistika për periudhën 2024 mendohet të realizohen në vlerë 160 mijë lek nga 430 mijë lekë të planifikuara. Kjo ndodh pasi edhe planifikimi I tyre bëhet vetëm mbi parashikime dhe jo mbi llogaritje konkrete për vetë natyrën e këtyre të ardhurave.

Keto ishin disa nga momentet kryesore gjatë zbatimit të buxhetit për vitin 2024.

- Hartimi I buxhetit për vitin 2025

Hartimi i buxhetit për vitin 2025 është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe akteve të tjera ligjore.

Gjithashtu hartimi i buxhetit për vitin 2025 është parë ngushtë lidhur edhe me problematikat e trajtuara me lart. **Planifikimi i cdo zëri të buxhetit është bërë për të qënë sa më eficient dhe i realizueshëm, me qëllim që gjatë vitit 2025 të kemi mundësi të financojmë buxhetin e këtij viti, të mbyllim pjesën e borxhit të trashëguar dhe të mos krijojmë detyrime të reja.** Për të aritur këtë rezultat duhet një punë me përgjegjshmëri nga i gjithë stafi i administratës së Këshillit të Qarkut. Gjithashtu kërkohet përgjegjësi nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Qarkut për realizimin e kontributit financiar të bashkive për këshillin e qarkut si detyrim ligjor për organet vendore të nivelit të dytë.

Planifikimi i të ardhurave

Për vitin 2025 buxheti total për Këshillin e Qarkut është planifikuar në vlerë 250.8 milion leke (duke mos e përfshirë transfertën e kushtëzuar të DAMT-së) duke synuar për të patur një buxhet sa më real dhe të mbuluar me fonde të realizueshme, përfshirë këtu edhe fondet që presim të arkëtojmë si rimbursime për shpenzimet e kryera nga buxheti I Qarkut për projektet e huaja të përfunduara në vitin 2023. Këto fonde janë parashikuar me kapitull 5 duke qënë se ato do të vijnë në formën e rimbursimit dhe projektet tashmë janë mbyllur.

Të ardhurat si burim i financimit të shpenzimeve janë planifikuar mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet e ardhura kryesore e buxhetit për organin vendor. **Për vitin 2025 Granti është celur në masën 82.8 milion lekë, me një rritje nga viti 2024 prej rreth 6.8 milion lekë. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes të transfertës të pakushtëzuar sektoriale për rritjen e pagave që u bë në Shtator të vitit 2024.**

Në planifikimin e të ardhurave janë mbajtur parasysh aktet ligjore në fuqi si dhe realizimi i tyre në periudhat e mëparshme. **Të ardhurat e veta në total janë planifikuar në masën 36.9 milion lekë.**

Në planin e të ardhurave peshën kryesore e kapin të ardhurat nga kontributi financiar i bashkive përbërëse të Këshillit të Qarkut. Kjo e ardhur është **planifikuar mbështetur në Ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 38, pika 3, ku citohet shprehimisht se kuota e anëtarësisë të bashkive përbërëse për financimin e buxhetit të qarkut percaktohet me vendim të këshillit bashkiak. Kjo rit përgjegjesinë e Bashkive për të planifikuar dhe derdhur në kohë këtë detyrim.** Kjo e ardhur në vitet e kaluara është realizuar në nivele të ulta duke krijuar deficite të ndjeshme në buxhetin e këshillit të qarkut dhe kjo për arsye që janë trajtuar shumë herë. Për vitin 2025 ky kontribut është planifikuar në nivelin 20 milion lekë, dhe 16.5 milion lekë janë

kontribute të bashkive që duhet të ishin derdhur në vitin 2024, por që nuk u realizuan. Për 36.5 milion lekë janë planifikuar për tu realizuar nga kontributet e bashkive dhe të gjitha këto kontribute janë alokuar në zëra investimesh sipas kërkesave të bashkive. Në varësi të kontributit që Bashkitë do të japin për Këshillin e Qarkut, do të jetë edhe mbështetja financiare e Këshillit të Qarkut për projekte të ndryshme investimi apo studimi.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut, janë planifikuar në të njëjtat nivele si dhe viti 2024 dhe më të ulta krahasuar me vitin 2023, në vlerë 430 mijë lekë, pavarësisht se realizimi i pritshëm i tyre është në nivele të ulta. Në këtë planifikim është marrë parasysh ecuria e këtyre të ardhurave në disa vite, meqenese nuk mund të bëhen llogaritje të sakta. Në këtë zë futen kryesisht të ardhurat nga tarifat e kadastrës dhe urbanistikes. Këshilli I Qarkut nuk ofron më shërbime në fushën e transportit pasi ato janë kompetencë e vetë bashkive.

Gjithashtu për vitin 2025 janë marrë në konsideratë përdorimi i të ardhurave të papërdorura deri tani në vlerë 76.6 milion lekë, të cilat kanë qënë të planifikuara kryesisht në zërin investime dhe studim projektive, të cilat nuk mund të realizoheshin brenda vitit 2024 pasi një pjesë e fondeve të dedikuara për këto investime kishin si burim kontributet e bashkive të cilat u arkëtuan shumë vonë.

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2025 është planifikuar një zë për rimbursimin e fondeve të shpenzuara nga buxheti I Qarkut për realizimin e projekteve të huaja. Këto projekte tashmë janë mbyllur, por kanë akoma fonde të padisbursuara nga donatorët. Duke qënë se këto fonde janë nga rimbursimet e shpenzimeve të kryera tashmë, ato janë planifikuara në kapitullin 5 dhe jo në kapitullin 2. Ky fond I planifikuar në vlerën 54.5 milion lekë është për rimbursimin e shpenzimeve që Qarku ka kryer për finalizimin e projekteve me financim të huaj dhe pasi kjo vlerë ti bashkohet faktikisht buxhetit të Këshillit të Qarkut, do të shpërndahet në aktivitete të ndryshme të Qarkut si dhe në projekte të reja të BE-se që Qarku synon të bëhet pjesë.

Bashkangjitur është pasqyra e tarifave që aplikon Këshilli I Qarkut për shërbimet që i ofron komunitetit, të miratuara këto me akte ligjore e nënligjore, si dhe pasqyra e llogaritjeve analitike të të ardhurave të parashikuara për vitin 2024.

Në total të ardhurat do të përdoren për financimin e funksioneve të veta të Këshillit të qarkut të miratuara me ligj.

Nuk është pjesë e këtij buxheti transferta e kushtëzuar.

Planifikimi i shpenzimeve

Pjesë e rëndësishme e planit të buxhetit është planifikimi i shpenzimeve. Nga ana e sektorit të finances dhe administrates të Këshillit të Qarkut, planifikimi i shpenzimeve është parë me kujdes në çdo element të tij mbi bazën e zbatimit të Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit si dhe të realizimit të buxhetit për vitin 2024, si dhe mbështetur në miratimin paraprak të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. Grupi i punës ka bërë parashikimin e buxhetit për vitin 2025 mbi bazën e programeve dhe aktiviteteve të miratuara si dhe përdorimit të disa programeve të tjera të cilat I kanalizojnë shpenzimet sipas llojit të tyre.

Në total buxheti për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 250.8 milion lekë me burim financimi transfertën e pakushtëzuar me vlerë 82.8 milion lekë, të ardhurat e

institucionit për vitin 2025 dhe trashëgimi nga viti 2024 me vlerë 113.5 milion leke, si dhe parashikimi për të ardhurat nga rimbursimet e shpenzimeve të kryera për projektet e huaja, 54.5 milion lekë. Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet një burim i rëndësishëm i financimit të shpenzimeve për Këshillin e Qarkut. Bashkëngjitur materialit është tabela analitike e llogaritjes të shpenzimeve të buxhetit.

Planifikimi i shpenzimeve të personelit

Në zbatim të Ligjit “Per buxhetin e vitit 2025”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” numri i punonjësve të stafit të administratës të Këshillit të Qarkut do të rritet me 3 punonjës, pra do të bëhen gjithsej 13 punonjës dhe 3 titullarë të zgjedhur dhe të emëruar. Në këto kushte si dhe në funksion të punës të Administratës, për vitin 2025 është planifikuar edhe një ndryshim i strukturës dhe për këtë arsye niveli i pagave ka pësuar një rritje krahasuar me vitin 2024. Në zbatim të VKM-së nr 503 dt 01.08.2024 Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe ndryshimit në numrin e punonjësve, fondi i pagave është llogaritur mbi bazën e këtyre të dhënave. Në vlerë pagat e sigurimet shoqërore për vitin 2025 janë 31.4 milion lekë dhe kapin 12.5 % të totalit të shpenzimeve. Brenda këtij fondi është llogaritur edhe transferata e pakushtëzuar specifike për pagat si dhe fondi i vecantë. Financimi i tyre është parashikuar me fonde nga transferata e pakushtëzuar dhe transferata e pakushtëzuar sektoriale që ka erdhur specifikisht për pagat.

Në buxhetin e vitit 2025 është planifikuar edhe financimi i shpërblyerit për anëtarët e kryesisë të Këshillit të Qarkut sipas vendimit përkatës në vlerë 1.6 milion lekë, 0.4 milion lekë më shumë nga viti 2024 si rezultat i rritjes të pagave sipas VKM-së të sipërpërmendur.

• Planifikimi i shpenzimeve operative për administratën e Këshillit të Qarkut

Planifikimi i shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera për vitin 2025 për administratën është bërë sipas klasifikimit ekonomik për çdo funksion në vecanti. Planifikimi i shpenzimeve operative për vitin 2025 për funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut është në nivelin 9.7 milion lekë ku është parashikuar edhe financimi i borxhit të trashëguar. Financimi i shpenzimeve operative do të bëhet me fonde nga transferata e pakushtëzuar. Niveli i këtyre shpenzimeve kap rreth 3.9 % të totalit.

Niveli i shpenzimeve është planifikuar mbi bazën e normativave të miratuara me akte ligjore për disa zëra shpenzimesh. Niveli i planifikuar i shpenzimeve mbulon aktivitetin e administratës së këshillit të qarkut në përmbushje të misionit të tij.

Disa nga zërat që zenë peshë në shpenzimet operative për administratën e K. Qarkut në total janë si më poshtë:

250,000	Riparim automjete dhe pjese kembimi
120,000	blerje pajisje kancelarie dhe boje per printera

120,000	blerje goma per automjetin
80,000	Siguracion per makinën
50,000	Shpenzime te tjera transporti dhe taksa per automjet
120,000	Blereje shtypshkrime dhe dokumentacioni
120,000	Mirembajtje dhe riparim pajisje zyre
120,000	Materiale te tjera elektrike, hidraulike etj
120,000	Materiale pastrimi
675,000	Sherbim pastrimi
100,000	Shpenzime dekorimi
120,000	Blerje suvenire per dhurata
120,000	Aktivitete dhe festa per nevoja te Keshillit te Qarkut
60,000	Shpenzime interneti
60,000	Shpenzime tel celular me kontrate dhe fix
160,000	Taksa vendore dhe shpenzime te tjera
100,000	Shpenzime postare
800,000	Shpenzime energji dhe uje
400,000	Bileta transporti ajror nderkombetar
800,000	Shpenzime per vendime gjyqesore
650,000	Kuota anetaresimi, SHKQ, AER etj
300,000	Detyrimet e trasheguara
120,000	Hostim dhe mirembajtje faqe interneti
40,000	Blerje kuti dhe dosje per ruajtje te perhershme arkivi
120,000	Konsulence per mbrojtjen ndaj zjarrit
1,300,000	Dieta honorare dhe shpenzime te tjera operative
655,000	Ekspertize e jashtme
1,000,000	Konsulenca te jashtme
1,000,000	Mjet per institucionin me leasing me kapacitet 5-12 persona

Brenda ketij zeri kemi llogaritur edhe Fondin Rezerve per vitin 2025 ne mase 2 milion leke.

Gjithashtu Keshilli I Qarkut ka planifikuar edhe shpenzime te tjera operative qe lidhen me programe te tjera shpenzimesh.

Programi : Mbështetja për zhvillimin ekonomik. Totali i shpenzimeve operative për këtë program është 9.8 milion lekë ose 4% të totalit të shpenzimeve. Disa prej zërave kryesorë të shpenzimeve që i përkasin këtij programi janë:

2,800,000	Prezantimi i produktit turistik rajonal ne panairë nderkombetare
1,500,000	Konferenca shkencore per prioritetet e zhvillimit te Qarkut
1,000,000	Studentet ne sipërmarje te lire

3,500,000 Organizim dhe mbeshtetje per te rinjte ne turizem.20 guica turistike
1,000,000 Aktiviteti "sportistet me te mire te qarkut

Programi: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore. Totali I shpenzimeve operative për këtë program është 10.5 milion lekë ose 4.2% të totalit.

1,500,000 Rin-Art Qarku Korce
1,800,000 Autonom fest
120,000 Ekspozita e koleksionisteve "Krahina autonome e Korces"
1,500,000 Aktivitete kulturore lokale ne bashkepunim me Bashkite
1,000,000 Nxitja e sipermarjes ne artizanat ne shkollat e mesme profesionale
730,000 Projekti "ArtKid"
500,000 Konkursi "Gjuha Ime"
400,000 Konferenca Filantropia ne rajonin e korces
300,000 Konferenca Zai Fundo(Llazar Fundo) nje personalitet europian
700,000 Olimpiadat e shkollave te mesme
1,000,000 Projekti EtnoKid
1,000,000 Promovimi i produkteve bujqesore dhe fermereve te rajonit te korces

Në këtë program kemi lënë edhe një zë : Për pjesëmarrje në projektet e BE-së në vlerën 40 milion lek dhe që do i shërbejë projekteve të reja me financim të huaj pjesë e të cilave do të jetë Këshilli i Qarkut Korçë. Ky fond do të shërbejë si garanci për parafinancimet si dhe për bashkëfinancimet e këtyre projekteve.

Programi: Përkujdesi social. Totali I shpenzimeve operative për këtë program është 10 milion lekë ose 4% e totalit.

9,000,000 Projekte sociale me bashkte e qarkut, moshat e trata dhe femijet e komuniteteve
410,000 Te verberit
150,000 Qendra rezidenciale e zhvillimit Korce
500,000 Aktiviteti tetori roze

Planifikimi I Investimeve

Për vitin 2025 janë planifikuar rreth 135.6 milion lekë investime ose 54 % të totalit të buxhetit, ku peshën kryesore do ta zenë investimet në programin e zhvillimit ekonomik. Realizimi I këtyre investimeve do të varet edhe nga kontributet e bashkive të Qarkut. Do të përfundohen investimet e përfunduar nga viti 2024. Zërat kryesorë të investimeve të planifikuara janë si më poshtë:

- Riparime në objekt dhe mirëmbajtje, 1 milion lekë
- Blerje pajisje per ngrohje, kondicionere, 600 mije leke
- Instalime dhe pajisje mbrojtjen nga zjarri, 600 mijë lekë
- Investime në bashkëpunim me bashkitë(raporti 60%me 40%), 50 milion lekë
- Ndertimi i Muzeut Dritero Agolli, 31.8milion lekë
- Rikonstruksioni i muzeut etnografik ne Bashkine Korce, 30 milion lekë

- Rikonstrukcion i Monumenteve e Lasgush Poradecit dhe Mitrush Kutelit 2 milion lekë
- Pajisje per qendren infopoint Erseke, 1.2 milion lekë
- Pergatitja e strategjise sektoriale te zhvillimit per Rajonin Korce, 2.5 milion lekë
- Projektet TIP (giz), 1 milion lekë
- Kthimi i monumentit Themistokli Germenji ne identitet, 1.5 milion lekë
- Projekt studimi, Muzeu I Sazeve ne Leskovik, 1.5 milion lekë
- Projekte studimi ne Bashkine Pustec, 5 milion lekë
- Projekt preventiv zbatimi Rehabilitimi i lagjes Muze Maliq, 923 mijë lekë
- Projekt preventiv zbatimi Ndertimi i muzeut te palafiteve dhe tharjes te kenetes te Maliqit, 6 milion lekë.

• **Planifikimi i bashkëfinancimit në Projektet e BE**

Për vitin 2025 Këshilli i Qarkut ka parashikuar me kapitull 5 te ardhura nga rimbursimet e shpenzimeve për projektet me financim të huaj të cilat janë përfunduar. Shpenzime këto që janë parafinancuar nga buxheti I Qarkut dhe që do të disbursohen nga donatorët pas certifikimit të shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera. Një pjesë e këtyre disbursimeve janë bërë në llogaritë e projekteve në bankën e nivelit të dytë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme nuk janë disbursuar akoma. Më pas, të gjitha këto fonde do të kalojnë në llogarinë e Këshillit të Qarkut në thesar, duke qënë se shpenzimet janë kryer paraprakisht me fondet e buxhetit të Qarkut. Ky limit është planifikuar rreth 54.5 milion lekë dhe kap rreth 21.7% te totalit të buxhetit.

Aktualisht për 3 projektet ka përfunduar edhe disbursimi I fondeve nga donatori pasi projektet janë mbyllur, ndërsa për 2 projektet e tjera presim akoma fonde për tu disbursuar.

Në momentin qe keto fonde do te behen pjese e buxhetit te Qarkut, do te perdoren pjesërisht per Projekte te reja me financim te huaj qe presim te marim dhe pjesërisht per aktivitete te tjera ne te mire te Rajonit tone.

Institucioni jone ka financuar 15 % te vleres si kontribut, gjithashtu jane mare masat edhe per financimin e vleres te TVSH, e cila nuk financohet me fonde te BE, si dhe parafinancimi me qellim ecurine normale te Programeve. Keshilli i qarkut po vazhdon punën për pjesëmarje në thirje të reja të celura nga Bashkimi European në bashkëpunim me partnere rajonale e ndërkombëtarë. Kjo do të bëjë të mundur vazhdimësinë e pjesëmarjes në keto Programe, të cilat do të sjellin nje stad të ri të zhvillimit të rajonit.

Për vitin 2025 nuk janë marrë parasysh në buxhet transfertat e kushtëzuara të DAMT-së dhe planit social.

Në total përqindjet e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike ndaj totali të buxhetit janë si më poshtë:

Shpenzimet operative	33%
Investimet	54%
Pagat	13%
Fondi rezerve	1%

Ky është një buxhet qe vjen i miratuar me Ligjin e Buxhetit.

Keto ishin zërat kryesore të Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025.

Bashkangjitur ketij material janë pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe pasqyra e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025.

Korcë me 12.12.2024

EMP-të
Oljona Beqiraj
Redin Latollari
Elona Mano
Marjona Bylykbashi
Flodi Mero
Mariela Alickolli
Paola Lara

KRYETARI
Erjon Nexhipi

